



WORLD BANK GROUP

BALLKANI PERËNDIMOR RAPORT I RREGULLT EKONOMIK  
Nr.19 | Pranverë 2021

# KOSOVA

RIMËKËMBJE E VËSHTIRË | RAPORT PËR VENDIN



Public Disclosure Authorized

Public Disclosure Authorized

Public Disclosure Authorized

Public Disclosure Authorized

© 2021 International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank  
1818 H Street NW  
Washington DC 20433  
Telephone: 202-473-1000  
Internet: [www.worldbank.org](http://www.worldbank.org)

Ky raport është produkt i stafit të Bankës Botërore me kontribute të jashtme. Gjetjet, interpretimet, dhe përfundimet e shprehura në këtë raport nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bankës Botërore, Bordit të Drejtorëve Ekzekutivë të Bankës Botërore, ose të qeverive që ata përfaqësojnë.

Banka Botërore nuk garanton saktësinë e të dhënave të përfshira në këtë raport. Kufijtë, ngjyrat, përcaktimet ose informacionet e tjera që përmban secila prej hartave në këtë dokument nuk nënkuptojnë asnjë interpretim nga ana e Bankës Botërore lidhur me statusin ligjor të ndonjë territori, ose miratimin apo pranimin e këtyre kufijve.

#### Të Drejtat dhe Lejet

Materiali në këtë raport është i mbrojtur nga e drejta e autorit. Meqënëse Banka Botërore nxit publikimin e punës së saj, ky raport mund të riprodhohet, i plotë ose pjesërisht, për qëllime jokomerciale me kusht që asaj t'i atribuohen të gjitha të drejtat për këtë raport. Të gjitha pyetjet lidhur me të drejtat dhe licencat, përfshirë të drejtat e riprodhimit, duhet të drejtohen në: World Bank Publications, The World Bank Group, 1818 H Street NW, Washington, DC 20433, USA; fax: 202-522-2625; e-mail: [pubrights@worldbank.org](mailto:pubrights@worldbank.org).

## Kosova

- Në vitin 2020, aktiviteti ekonomik u tkurr me rreth 6.9 për qind për shkak të rënies së eksportit të shërbimeve (të ndërlidhur me diasporën), investimeve totale, dhe konsumit privat. Politikat mbështetëse dhe një ngritje domethënëse e remitencave dhe eksportit të mallrave zbutën ndikimin ekonomik të pandemisë.
- Aktiviteti ekonomik pritet të rritet më 2021, por rreziqet globale dhe të brendshme janë të konsiderueshme, përfshirë këtu vonesat në prokurimin dhe shpërndarjen e vaksinave, kufizimet e udhëtimit ndërkombëtar, dhe rivendosja e masave të rrepta për frenimin e pandemisë.
- Targetimi më i mirë i masave mbështetëse është vendimtar për të rritur ndikimin e tyre dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë fiskale. Adresimi i pengesave strukturore afatgjata dhe investimi në kapital njerëzor janë jetike për një rimëkëmbje dhe rritje afatgjate të qëndrueshme.

### Zhvillimet e fundit ekonomike

**Ekonomia e Kosovës regjistroi tkurrjen e saj të parë nga shpallja e pavarsisë.** Nga 2009 në 2019 rritja ishte mesatarisht 3.6 për qind. Në vitin 2020, aktiviteti ekonomik u tkurr me rreth 6.9 për qind, kryesisht për shkak të një rënieje prej 51 për qind në eksportin e shërbimeve të udhëtimit, që ndërlidhen me diasporën, si dhe rënies së investimeve. Rritja e konsumit qeveritar dha një kontribut modest pozitiv; por, përkundër përkrahjes nga shkalla më e lartë e transfereve qeveritare dhe dërgesave të diasporës, vlerësohet se konsumi privat zbriti 0.2 pikë përqindjeje (pp) nga rritja. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës<sup>1</sup>, deri në tremujorin e tretë të vitit 2020 ekonomia ishte tkurrur me 5.6<sup>2</sup> për qind. Qarkullimi i deklaruar ra me 9.5 për qind në baza vjetore, duke pasqyruar ndikimin e rëndë të krizës në sektorin privat.

**Masat e politikave mbështetëse, së bashku me rritjen e remitencave dhe eksportit të mallrave, zbutën tkurrjen.** Eksportet e mallrave amortizuan rënien; ato u rritën me 21 për qind—të nxitura nga kërkesa më e lartë

ndërkombëtare për nikel si dhe përmirësimi i qasjes në tregun e huaj për subjektet që eksportojnë mallra të prodhuara. Edhe eksportet e shërbimeve u rigjallëruan gjatë tremujorit të katërt të vitit 2020, duke kufizuar paksa humbjet që tashmë ishin të konsiderueshme. Një ngritje domethënëse e remitencave prej 15.1 për qind i dha shtytje të ardhurave të disponueshme. Ndërkohë, transferet publike – kryesisht si rezultat i masave mbështetëse për t’iu kundërvënë ndikimit të pandemisë—shënuan një rritje prej 38.3 për qind, duke mbështetur të ardhurat e disponueshme me mbi 240 milionë euro.

**Tregu i punës reagoi kryesisht duke reduktuar angazhimin në punë dhe kompensimin,** sipas rezultateve të Anketës së Pulsit të Biznesit (APB) të kryer nga Banka Botërore në TM2 2020. Në përputhje me gjetjet e APB, të dhënat tatimore tregojnë se punësimi formal i bëri ballë ndikimit të rënies. Subvencionimi i pagave dhe masat e tjera të politikave mbështetëse jo vetëm që duket se kanë ndihmuar në ruajtjen e vendeve të punës në sektorin formal, por gjithashtu kanë inkurajuar formalizimin e punësimit. Sidoqoftë,

<sup>1</sup> Ky publikim nuk përfshin vlerësimet e përkohshme të BPV-së për tremujorin e katërt të vitit 2020 të botuara më 2 prill 2021, duke pasur parasysh mospërputhjet teknike me publikimin vjetor dhe statistikave të bilancit të pagesave (BP) për

vitin 2019, si dhe rishikimin e parashikuar të statistikave të llogarive kombëtare.

<sup>2</sup> Të gjitha krahasimet janë vit-më-vit, përveç nëse tregohet ndryshe

një rënie prej 4.2 për qind e të hyrave nga tatimi mbi të ardhurat personale tregon se tkurrja reduktoi kompenzimin dhe kufizoj oraret e punës në sektorin formal. Ndërkohë, sipas të dhënave administrative nga qendrat e punësimit, pati rritje të shkallës së papunësisë, me gjasë për shkak të humbjes së vendeve të punës në sektorin joformal. Sidoqoftë, përmasat e kësaj rritjeje nuk dihen sigurt, duke pasur parasysh se statusi i regjistruar i papunësisë ishte një parakusht për të përfutur edhe nga masat qeveritare të mbrojtjes sociale.

**Deficiti buxhetor është rritur më shumë se dyfish në vitin 2020,** duke arritur 7.6 për qind të BPV-së në 2020, nga 2.9 për qind në 2019; dhe kjo përkundër një rënieje prej 28.4 për qind të investimeve publike. Tkurrja ekonomike shkaktoi rënie të të hyrave publike me gati 9 për qind, kryesisht për shkak të rënies së të hyrave tatimore. Shpenzimet publike rrjedhëse u rritën me një shkallë rekorde prej 18.6 për qind, të nxitura nga shpenzimet e lidhura me pandeminë. Qeveria shpenzoi rreth 4.4 për qind të BPV-së në kundërpërgjigje ndaj pandemisë, me një shumë të vlerësuar prej 0.9 për qind për koston shtesë të menaxhimit të pandemisë (shtesa të pagave dhe mallra dhe shërbime) dhe 3.5 për qind për transferet e drejtpërdrejta për mbrojtjen sociale, punësimin dhe mbështetjen e ndërmarrjeve dhe bujqve.<sup>3</sup> Kosova financoi deficitin duke emetuar borxh të ri të brendshëm të vlerësuar në 2.5 për qind të BPV-së, duke mobilizuar 3.3 për qind të BPV-së në borxh të jashtëm koncesionar dhe duke u mbështetur në pranimet nga likuidimi (1.1 për qind të BPV-së) dhe depozitat qeveritare. Borxhi publik dhe i garantuar publikisht u rrit me 5.2 pp të BPV-së, duke arritur 22.8 për qind të BPV-së. Qeveria gjithashtu mori përsipër detyrimin për të kompensuar nga viti 2023 tërheqjet nga FKPK-ja në vlerë prej 1.5 për qind të BPV-së, apo

gjysmën e tërheqjeve totale prej 3 për qind të BPV-së që ndodhën ndërmjet fundit të dhjetorit 2020 dhe janarit 2021.

**Inflacioni i çmimeve të konsumit (CPI) në vitin 2020 ishte i ulur, duke u ngadalësuar ndjeshëm nga viti 2019.** Inflacioni i çmimeve të konsumit (IÇK) në vitin 2020 ishte mesatarisht 0.2 për qind, me rënie të konsiderueshme nga 2.7 për qind më 2019. Presionet inflacionare ishin të zbehta për shkak të një kërkese të brendshme të plogësht dhe rënies së çmimeve të importit. Presionet inflacionare filluan të rriten në qershor 2020 pas lehtësimit të masave të rrepta për frenimin e pandemisë, por morrën kahje të kundërt në korrik dhe qëndruan në teritor negativ deri në dhjetor 2020. Çmimet e importit ndoqën një trend deflacioni gjatë gjithë vitit; çmimet ranë më së shumti në TM2, por inflacioni iu afrua shkallës pozitive nga fundi i vitit.

**Rënia e importeve dhe një rritje e të ardhurave dytësore pothuajse kompensuan rënien e thellë të eksporteve.** Si rezultat, deficiti i llogarisë rrjedhëse u përkeqësua vetëm lehtësisht, nga 5.5 për qind e BPV-së në 2019 në 5.7 për qind. Bilanci i llogarisë rrjedhëse (BLLR) u financua kryesisht nga investimet e huaja direkte (IHD) neto dhe flukse të tjera hyrëse të investimeve. Përkundër një rënieje prej 10.7 për qind të bruto flukseve hyrëse të investimeve të huaja direkte, reduktimi i fluksit dalës të investimeve të huaja direkte dhe rënia në dividendat e rikthyera çoi në një rritje prej 42 për qind të neto investimeve të huaja direkte. Investimet e tjera u rritën gjithashtu me 52 për qind, duke reflektuar kryesisht hyrjet nga kreditë e jashtme publike.

**Në vitin 2020 sektori financiar i Kosovës e përballoi mirë pandeminë, por ndikimi i plotë në cilësinë e portofolit kreditor**

<sup>3</sup> Ky vlerësim përjashton ndikimin e shtyrjeve të afateve tatimore dhe lirimeve tatimore, të cilat u ndërprejnë gjatë gjysmës së dytë të vitit 2020.

**mbetet pr tu vlerësuar.** Depozitat bankare u rritën me 11.5 për qind, me rritje të depozitave familjare me gati 13 për qind. Kreditimi bankar u rrit me 7.1 për qind, por kreditë e reja u rritën me vetëm 1.8 për qind, duke reflektuar ristrukturimet e konsiderueshme gjatë gjithë vitit. Kreditë nga institucionet mikrofinanciare të cilat përbënin rreth 6 për qind të totalit të kredive në dhjetor 2020, ranë me 6.8 për qind në baza vjetore. BQK-ja nxori një vendim në mars për të shtyrë pagesat e kësteve kreditore, që rezultoi në një moratorium 3-mujor të pagesës së kësteve kreditore që arriti më shumë se 50 për qind të totalit të kredive bankare. Me mbylljen e kësaj dritareje, BQK-ja në qershor lejoi aplikime për zgjatje të kredisë deri në një vit dhe ristrukturime sipas rastit. Kjo është pjesërisht arsyeja pse ndikimi i plotë i pandemisë në cilësinë e portofolit kreditor nuk mund të vlerësohet ende. Deri në fund të vitit 2020, mjaftueshmëria e kapitalit ishte mbi kërkesat rregulatore dhe norma e kredive jo-performuese ishte rritur me 0.7 pp krahasuar me një vit më parë.

### **Parashikimi dhe rreziqet**

**Rritja pritet të rigjallërohet në 2021, por rreziqet janë të konsiderueshme.** Rimëkëmbja ekonomike do të jetë graduale: në përputhje me trendin global, aktiviteti real do të arrijë nivelet para-pandemike vetëm më 2022. Rimëkëmbja do të udhëhiqet nga një rritje e eksporteve dhe e konsumit. Rritja në eksportet e mallrave do të duhej të jetë e fortë në periudhën afatmesme, sepse çmimet e metaleve bazë pritet të rriten. Me lehtësimin e kufizimeve të udhëtimit ndërkombëtar dhe përsheptimin e prokurimit dhe administrimit të vaksinave në Evropë, eksportet e shërbimeve do të duhej të rimëkëmbeshin gjithashtu nga një rimëkëmbje e shpenzimeve turistike të diasporës. Konsumi privat pritet të kontribuojë në rritje, i nxitur nga

mbështetja e vazhdueshme e politikës fiskale, ndikimi i tërheqjeve nga llogaritë e pensioneve në FKPK-së, dhe një rimëkëmbje e të ardhurave të disponueshme në 2021. Kapitalizimi i mëtejshëm i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore dhe rritja e tavanit të mbulimit me garanci gjithashtu do të duhej të mbështesin rimëkëmbjen.<sup>4</sup> Perspektiva e parashikuar bazohet në supozimet e lëvizshmërisë së relaksuar ndërmjet Evropës dhe Kosovës, pa masa të mëtejshme të rrepta për frenimin e pandemisë në nivelin lokal, një rimëkëmbje të rritjes në Eurozonë dhe një rritje në çmimet e metaleve bazë dhe mineraleve. Rritja ekonomike parashikohet të mbetet mbi 4 për qind në periudhën afatmesme, por rreziqet ndaj parashikimit janë të larta. Në 2021 dhe më tej, një përkeqësim eventual i pandemisë që kërkon medoemos rivendosjen e masave të rrepta për frenimin e pandemisë, vendosja e kufizimeve të reja të udhëtimit ndërkombëtar, dhe rritja më e ulët sesa ajo e parashikuar në BE, të gjithë këta faktorë mund të rëndojnë mbi rritjen dhe shpejtësinë e rimëkëmbjes. Ekziston gjithashtu një potencial për rritje më të lartë, përmes zbatimit më të shpejtë të investimeve publike të financuara nga institucionet financiare ndërkombëtare (IFI).

**Në vitin 2021, deficitin fiskal do të vazhdojë të jetë i lartë, i nxitur nga masat mbështetëse të rimëkëmbjes dhe çrregullimi i shkaktuar nga pandemia në trajektoren e rritjes.** Të hyrat pritet të rimëkëmben ndërsa aktiviteti ekonomik fillon të rritet, por ka të ngjarë të qëndrojnë nën nivelin e 2019. Pakoja e lehtësimit dhe rimëkëmbjes në mbështetje të bizneseve dhe individëve do të duhej të ekzekutohet plotësisht në 2021, me rreth 3.2 për qind të BPV-së. Deficiti i përgjithshëm fiskal pritet të arrijë 5.1 për qind të BPV-së. Nën supozimin që deri në vitin 2022 deficitin do të jetë në

<sup>4</sup> Masa e Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike për të rritur mbulimin e garancisë kreditore në 80 për qind dhe për të subvencionuar tarifën e garancisë—e

zbatuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore dhe e financuar nga Banka Botërore—pritet të rritë kërkesën për kredi të reja në 2021.

përputhje me rregullat fiskale, borxhi publik dhe i garantuar publikisht do të arrinte 28.2 për qind të BPV-së në 2023, pothuajse dyfishi i nivelit të vitit 2016. Duke marrë parasysh pasigurinë në lidhje me pandeminë dhe ngushtimin e hapësirës fiskale; do të jetë me rëndësi të targetohen më mirë masat mbështetëse për të rritur ndikimin e stimulit fiskal dhe duke ruajtur njëkohësisht qëndrueshmërinë fiskale.


**Si në vitin 2020, deficitin e llogarisë rrjedhëse do të duhet të sillt rreth 5.7 për qind të BPV-së.** Eksportet priten të rriten për shkak të rritjes së çmimeve të metaleve bazë, rimëkëmbjes së turizmit që lidhet me diasporën dhe një rritjeje të kërkesës së jashtme. Sidoqoftë, rigjallërimi i eksporteve do të kundërpeshohet pjesërisht nga rritja e kërkesës për import gjersa konsumi dhe investimet fillojnë të rriten gjatë vitit 2021. Ndërsa remitencat e konsiderueshme do vazhdojnë të ulin deficitin e llogarisë rrjedhëse, niveli i tyre parashikohet të jetë më i ulët se në vitin 2020; duke kundërpeshuar më tej rigjallërimin e eksporteve, dhe duke çuar në një deficit të llogarisë rrjedhëse prej 5.7 për qind të BPV-së, ngjashëm me vitin e kaluar.

**Progresi në reformat strukturore është jetik për të zmbarsur ndikimin e pafavorshëm**

**ekonomik dhe social të pandemisë dhe për të ndërtuar qëndrueshmëri ndaj goditjeve negative në të ardhmen.** Epidemia ka vërtetuar rëndësinë e mekanizmave të mbrojtjes sociale që funksionojnë mirë dhe që mund të identifikojnë e mbështesin grupet më të cenuara nga goditjet e pafavorshme ekonomike, pa cenuar rezervat fiskale. Targetimi më i mirë i shpenzimeve të mbrojtjes sociale për më të varfrit është vendimtar si për uljen më të shpejtë të varfërisë ashtu edhe për të parandaluar rëniet e hovshme të konsumit (duke shërbyer si stabilizues automatic). Për të mbështetur një rritje të lartë dhe gjithëpërfshirëse, është gjithashtu e nevojshme që Kosova t'i japë shtytje produktivitetit duke përmirësuar mjedisin afarist. Synim duhet të jetë reduktimi i barrës administrative për ndërmarrjet, p.sh., duke koordinuar më mirë inspektimet, duke adoptuar politika të targetuara të inovacionit dhe konkurrueshmërisë së gjelbër për ndërmarrjet mikro dhe të vogla, duke investuar në kapitalin njerëzor, dhe duke përmirësuar sundimin e ligjit në mënyrë që të gjitha ndërmarrjet dhe qytetarët të trajtohen drejtë. Shfrytëzimi i investimeve të deritanishme në infrastrukturën digjitale në periudhën afatmesme do t'i japë Kosovës një mundësi për të zgjeruar qasjen në tregje, për të promovuar përfshirjen dhe për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve publike.

**Ekonomia e Kosovës u turr për herë të parë në vitin 2020, por pritet të rimëkëmbet gradualisht.**


kontributi në rritje, pikë përqindjeje



Burimi: Llogaritjet dhe projektionet e stafit të Bankës Botërore.

**Deficiti fiskal u rrit me hov në vitin 2020, por parashikohet të ngushtohet në periudhën afatmesme**


në përqindje të BPV-së



Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritjet e stafit të Bankës Botërore.

**Aktiviteti ekonomik filloj të rritej nga tremujori i katërt të vitit 2020.**


ndryshimet tremujore nga 2019 në 2020 për tregues të përzgjedhur



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe llogaritjet e stafit të Bankës Botërore.

**Eksportet e shërbimeve shënuan rënie të thiktë, por eksportet e mallrave u rritën, megjithëse nga një bazë më e ulët.**


eksportet e mallrave dhe shërbimeve (në mil. EUR)



Burimi: Llogaritjet dhe projektionet e stafit të Bankës Botërore.

**Inflacioni i çmimeve të konsumit ishte i zbehtë në vitin 2020.**


inflacioni IÇK-së, në përqindje



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës.

**NPL-të janë përkeqësuar paksa, por mjaftueshmëria e kapitalit është mbi kërkesat rregullatore**

për qind



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës.

KOSOVA	2017	2018	2019	2020v	2021p	2022p
Rritja e BPV-së reale (në përqindje)	4.2	3.8	4.9	-6.9	4.0	4.5
Përbërja (pikë përqindjeje):						
Konsumi	1.5	5.4	2.7	0.5	1.0	2.1
Investimet	1.5	2.1	1.9	-3.9	0.9	1.8
Eksportet neto	1.2	-3.8	0.2	-3.5	2.1	0.7
Eksportet	4.0	1.0	2.1	-7.9	5.8	3.7
Importet (-)	2.8	4.8	1.9	-4.4	3.7	3.0
Inflacioni i çmimeve të konsumit (në përqindje, mesatarja e periudhës)	1.5	1.1	2.7	0.2	0.7	1.0
Të hyrat publike (në përqindje të BPV-së)	26.4	26.1	26.6	25.8	26.4	26.5
Shpenzimet publike (në përqindje të BPV-së)	27.6	29.0	29.5	33.4	31.5	29.6
Prej të cilave:						
Shpenzime për paga (në përqindje të BPV-së)	8.6	8.8	8.7	9.9	9.3	8.7
Asistencë sociale (në përqindje të BPV-së)	6.1	6.1	6.2	7.8	6.9	6.3
Shpenzime kapitale (në përqindje të BPV-së)	7.3	7.9	7.5	5.7	5.8	6.3
Bilanci fiskal (në përqindje të BPV-së)	-1.2	-2.9	-2.9	-7.6	-5.1	-3.1
Bilanci primar fiskal (në përqindje të BPV-së)	-0.9	-2.7	-2.6	-7.2	-4.6	-2.4
Borxhi publik (në përqindje të BPV-së)	15.6	16.3	16.9	22.3	24.9	26.5
Borxhi publik dhe i garantuar publik (në përqindje të BPV-së)	16.3	16.9	17.5	22.8	25.2	26.7
Prej të cilit: I jashtëm (në përqindje të BPV-së)	6.6	6.2	5.8	7.9	8.7	9.1
Eksportet e mallrave (në përqindje të BPV-së)	5.9	5.6	5.5	7.1	7.2	6.9
Importet e mallrave (në përqindje të BPV-së)	44.3	46.3	45.5	45.6	45.9	44.2
Eksportet neto të shërbimeve (në përqindje të BPV-së)	12.9	12.7	13.1	7.0	10.5	11.1
Bilanci tregtar (në përqindje të BPV-së)	-25.5	-28.0	-26.9	-31.5	-28.2	-26.2
Fluksi hyrës i remitancave, neto (në përqindje të BPV-së)	11.1	11.3	11.6	14.2	12.8	12.5
Bilanci i llogarisë rrjedhëse (në përqindje të BPV-së)	-5.4	-7.6	-5.5	-5.7	-5.7	-4.9
Flukset hyrëse neto të investimeve të huaja direkte (në përqindje të BPV-së)	3.3	3.4	2.7	4.0	3.2	3.2
Borxhi i jashtëm (në përqindje të BPV-së)	32.6	30.3	30.3	37.8	39.6	38.5
Rritja reale e kreditimit privat (në përqindje, mesatarja e periudhës)	8.8	10.1	7.8	7.6	n.a.	n.a.
Kreditë jo-performuese (në përqindje të totalit të kredive, fundi i periudhës)	3.1	2.5	2.0	2.7	n.a.	n.a.
Norma e papunësisë (në përqindje, mesatarja e periudhës)	30.5	29.5	25.7	n.a.	n.a.	n.a.
Norma e papunësisë së të rinjve (në përqindje, mesatarja e periudhës)	52.7	55.4	49.4	n.a.	n.a.	n.a.
Norma e pjesëmarrjes në forcën e punës (në përqindje, mesatarja e periudhës)	42.8	40.9	40.5	n.a.	n.a.	n.a.
BPV për frymë (US\$)	3,956	4,424	4,424	4,145	4,317	4,527

Burimet: Autoritetet kombëtare, vlerësimet dhe projeksionet e Bankës Botërore.



---

Këtë raport mund ta gjëni online:  
[www.worldbank.org/eca/wbrer](http://www.worldbank.org/eca/wbrer)

